

KATALOG “SHËRBIME NË FUSHËN E SIGURIMEVE”

20.06.2025

PËRMBAJTJA

Fjalor i termave.....faqe 4-6

Hyrje.....faqe 7

Të dhëna teknike të përgjithshme.....faqe 8

1. SIGURIM I MJETEVE MOTORIKE

1.1 “Sigurim i detyrueshëm i mjeteve motorike (TPL)”.....faqe 9

1.2 Objekti.....faqe 9

1.3 Fusha e veprimit.....faqe 9

1.4 Sigurim i detyrueshëm i përgjegjësisë ndaj palëve të treta.....faqe 10-12

1.5 Trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim.....faqe 10-12

1.6 Primi i sigurimit për TPL e brendshme.....faqe 12

1.7 Tabela e shërbimeve me çmimet e unifikuara.....faqe 12-15

1.2 “Sigurim kasko i mjeteve motorike”

1.2.1 Objekti.....faqe 15

1.2.2 Mbulimet.....faqe 15

1.2.3 Lista e shërbimeve KASKO me çmimet e unifikuara.....faqe 17

2. SIGURIM I MJETEVE LUNDRUESE

2.1 Objekti.....faqe 18

2.2 Fusha e veprimit.....faqe 18

2.3 Sigurim i detyrueshëm i përgjegjësisë ndaj palëve të treta.....faqe 18

2.4 Kufiri minimal i përgjegjësisë.....faqe 19

2.5 Trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim.....faqe 19

2.6 Humbja dhe dëmtimi i mjetit lundrues (KASKO).....faqe 19

2.7 Tabela e shërbimeve me çmimet e unifikuara.....faqe 20

3. SIGURIM I MJETEVE AJRORE

3.1 Objekti.....faqe 21

3.2 Fusha e veprimit.....faqe 21

3.3 Sigurim i detyrueshëm i përgjegjësisë ndaj palëve të treta.....faqe 21

3.4 Përgjegjësia ligjore për pasagjerët.....faqe 22

3.5	Përgjegjësia ligjore për palët e treta.....	faqe 22
3.6	Kufiri minimal i përgjegjësisë.....	faqe 22
3.7	Humbja dhe dëmtimi i avionit (KASKO).....	faqe 23
3.8	Tabela e shërbimeve me çmimet e unifikuara.....	faqe 24

4. SIGURIM I GODINAVE PUBLIKE

4.1	Kushtet e përgjithshme të sigurimit të pronës.....	faqe 25
4.2	Objekti i sigurimit.....	faqe 25
4.3	Rreziqet e sigurimit.....	faqe 25
4.4	Shuma e siguruar.....	faqe 26
4.5	Polica dhe periudha e sigurimit.....	faqe 27
4.6	Primi i sigurimit.....	faqe 27
4.7	Ngjarja e sigurimit dhe kërkesa për dëmshpërblim.....	faqe 27
4.8	Lista e shërbimeve me çmimet e unifikuara.....	faqe 28

FJALORI I TERMAVE

OBP → Operatori i Blerjeve të Përqendruara

AMF → Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

AKSIDENT → ngjarja ku rezulton dëm nga përdorimi i mjetit të transportit.

AVION → është çdo mjet transporti sipas përcaktimeve të dhëna në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë.

DËMI NDAJ PRONËS → është dëmi i pësuar si rezultat i dëmtimit ose i shkatërrimit të pronës.

DËMI NDAJ PERSONIT → është dëmi që vjen si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore dhe përkeqësimeve të shëndetit, që pëson pala e dëmtuar ose të afërmit e tij. Këtu përfshihet dëmi pasuror dhe dëmi jopasuror.

DËMI PASUROR → është humbja e pësuar nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimi i munguar.

DËMI JOPASUROR → është dëmi biologjik, ekzistencial dhe moral, i pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore, që lidhet me dhimbjet fizike, paaftësinë për punë, frikën, shëmtimin, dhimbjet dhe vuajtjet shpirtërore të personit të dëmtuar dhe familjarëve të tij në rastin e vdekjes së personit ose përkeqësimit të shëndetit të tij.

E DREJTË E POSAÇME E TËRHEQJES (*Special Drawing Rights – SDR*) → është njësi monetare e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

I SIGURUAR → është personi, humbja e mundshme pasurore dhe/ose jopasurore e të cilit është objekt i një kontrate sigurimi..

KASKO → produkt vullnetar sigurimi, i cili ofron mbulim për dëmet e shkaktuara vetë mjetit motorik nga rreziqet e parashikuara në kontratë dhe të përzgjedhura nga vetë klienti.

KUFIRI MINIMAL I PËRGJEGJËSISË → është shuma maksimale e dëmshpërblimit për çdo figurë dëmi, të njohur nga ligji nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, që siguruesi merr përsipër t’u dëmshpërblejë palëve të treta të dëmtuara në një ngjarje sigurimi.

MJET MOTORIK → nënkupton një mjet që lëviz në tokë, por jo mbi shina, me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave dhe është subjekt i detyrimit për regjistrim. Mjete motorike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysmë rimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës.

MASA MAKSIMALE E NGRITJES (MMN) → është maksimumi i masës me të cilën avioni mund të ngrihet në fluturim, e cila korrespondon me një masë specifike për secilin tip avioni, siç përcaktohet në certifikatën e vlefshmërisë ajrore të avionit.

MJET LUNDRUES → është çdo mjet transporti i destinuar për lundrim, i regjistruar sipas përcaktimeve të Kodit Detar.

MJET TRANSPORTI → është mjete motorik, mjete lundrues dhe mjete ajror.

PRIMI I SIGURIMIT → Primi i sigurimit nënkupton shumën e paguar nga i siguruari, ose nga një person që vepron në emër të tij, kundrejt sigurvearit, me qëllim sigurimin ndaj një rreziku të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

POLICA E SIGURIMIT → Kontrata e sigurimit e lidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PALA E DËMTUAR → është çdo person që ka pësuar dëme si pasojë e aksidentit, të cilit i lind e drejta të kërkojë dëmshpërblim, për humbjet apo dëmtimet e pësuar, të shkaktuara nga mjete i transportit.

PËRFITUES → nënkupton personin që gëzon të drejtën e dëmshpërblimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit.

PËRDORUES I NJË MJETI TRANSPORTI → është një person fizik apo juridik, që përdor mjete motorik me miratimin e pronarit.

PJESA E ZBRITSHME → nënkupton pjesën e pagueshme të dëmit në ngarkim të të sigurvearit, e shprehur në vlerë monetare ose në përqindje të limitit të përgjegjësisë/shumës së sigurimit.

SIGURUES → Shoqëri sigurimi, e licencuar nga AMF për të kryer aktivitetin e sigurimit në Republikën e Shqipërisë, e cila merr përsipër sigurimin e një rreziku sipas kontratës së sigurimit.

SIGURIM → është transferimi i një rreziku të mundshëm, i një humbjeje pasurore dhe/ose jopasurore nga i siguruari te sigurveari, sipas një kontrate sigurimi.

SIGURIM JETE → sigurimi i rrezikut, sipas klasave të përcaktuara në aneksin I, seksioni B, të ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

SHUMA E SIGURUAR → vlera, për të cilën është rënë dakord midis palëve në kontratën e sigurimit, apo është përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për sigurimin e detyrueshëm dhe që përfaqëson kufirin maksimal të përgjegjësisë së siguruesit kundrejt të sigurvearit/përfituesit.

TPL→ Sigurimi i Detyrueshëm i Mbajtësit të Mjetit Motorik për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta.

HYRJE

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sha, në zbatim të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në zbatim të nenit 13 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 531 datë 7.9.2023 *“Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë”, të ndryshuar, konkretisht pika 13/4 ku përcaktohet se: “OBP sh.a. standardizon/unifikon specifikimet teknike/çmimet për mallra dhe/ose për shërbime që prokurohen në mënyrë të përqendruar, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas apo të huaj, dhe harton katalogët e standardeve...”* ka hartuar katalogun me specifikimet teknike dhe çmimet e unifikuara për objektin e prokurimit: “Shërbime në fushën e sigurimeve si: sigurim i mjeteve motorike; sigurim i mjeteve lundruese; sigurim i mjeteve ajrore dhe sigurim i godinave publike”.

Në gërmën “g”, të pikës 11, të VKM-së nr 531 datë 7.9.2023, e ndryshuar është përcaktuar: *“Operatori i Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, si: ... g) “Shërbime në fushën e sigurimeve si: sigurim i mjeteve motorike; sigurim i mjeteve lundruese; sigurim i mjeteve ajrore; sigurim jete dhe shëndeti dhe sigurim i godinave publike”.*

TË DHËNA TEKNIKE TË PËRGJITHSHME

Specifikimet Teknike janë hartuar nga pikëpamja teknike, ekonomike dhe funksionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe konkretisht:

- Ligjin Nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- VKM Nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a. për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë”, të ndryshuar.
- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.
- Ligjin 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- Ligjin 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
- Rregulloren nr.156 datë 19.09.2024, “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në llogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- Rregulloren nr. 125, datë 28.07.2021, “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Specifikimet teknike të përgjithshme të siguracioneve kanë të përcaktuara fushën e veprimit, objektet që përfshihen në kontratat e sigurimit, si dhe kushtet për dëmshpërblim ndaj palëve të dëmtuara. Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim që të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi.

Primet mesatare për kategoritë: “Sigurim mjetesh lundruese, “Sigurim mjetesh ajrore” dhe “Sigurim i godinave publike” janë orientuese për tregun sepse primi i sigurimit mund të ndryshojë rast pas rasti sipas faktorëve të ndryshëm.

1. SIGURIM I MJETEVE MOTORIKE

1.1 “Sigurimi i detyrueshëm i mjeteve motorike (TPL)”

1.1. Objekti

Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike në sektorin e transportit.

1.2 Fusha e veprimit

Sigurimi i detyrueshëm i mjeteve motorike në sektorin e transportit, përfshin:

- a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
- b) sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik.

1.3 Sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

Pronari i mjetit motorik, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë për dëmet që mund t’ju shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, me pasojë dëmtimin e pronës, vdekjen, dëmtimet trupore dhe përkeqësimin e shëndetit, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 32, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Kjo kontratë sigurimi mbulon përgjegjësinë e të siguruarit ndaj palëve të treta për dëme të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në territoret e shteteve të tjera, me të cilat, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje.

Shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit të detyrueshëm për mjetet motorike, duke marrë parasysh faktorët e riskut. Shoqëria e sigurimit fillon të zbatojë tarifat, pasi ka njoftuar zyrtarisht AMF-në.

Në kuadër të Ligjit 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” pronari i çdo mjeti transporti përpara përdorimit të mjetit është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim. Çdo automjet që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jetë i pajisur me policën e sigurimit TPL (Sigurimi i Detyrueshëm i Mbajtësit të Mjetit Motorik për

Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta). Përmes këtij produkti mbulohen përgjegjësitë e mbajtësit të mjetit motorik ndaj palëve të treta, në përputhje të plotë me parashikimet ligjore.

Ky sigurim përfshin mbulimin e shpenzimeve si pasojë e dëmeve ndaj pronës dhe/ose ndaj personit sipas kontratës së sigurimit, të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit motorik të siguruar.

1.4 Trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim

Përfituesi ose pala e dëmtuar, ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguruesi përgjegjës i pronarit të mjetit shkaktar aksidenti. Siguruesi përgjegjës, në përputhje edhe me parashikimet e rregullores nr. 125, datë 28.07.2021, “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, brenda afateve të mëposhtme:

- a) për dëme ndaj personit, brenda 90 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për dëmshpërblim;
- b) për dëme ndaj pronës, brenda 30 ditëve nga data e të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për dëmshpërblim:
- c) përjashtimisht nga parashikimi i pikës b) më sipër, kërkesat për dëmshpërblim për dëme ndaj pronës me vlerë deri në 100 000 lekë, do të paguhen nga shoqëritë e sigurimit brenda 14 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, në rast pranimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj dhe duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 ditëve kalendarike pas përfundimit të afatit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimi të dëmshpërblimit.

1.5 Përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit dhe shuma e siguruar

Detyrimi i shoqërisë së sigurimit, që rrjedh nga kontrata e sigurimit, përfaqësohet nga kufijtë minimalë të mbulimit të vlefshëm në ditën e aksidentit, përveç rastit kur në kontratën e sigurimit përcaktohet një vlerë më e lartë.

1. Kufiri minimal i përgjegjësisë, që mbulohet nga kontrata e sigurimit, për dëme të shkaktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një ngjarje është si më poshtë:

a) për dëme pasurore dhe jopasurore, me pasojë vdekjen, dëmtime shëndetësore dhe përkeqësime të shëndetit, të shkaktuara nga një aksident ose seri aksidentesh të ardhura nga një ngjarje sigurimi:

- i) për autobusë dhe kamionë, përfshirë rimorkiot 150 000 000 lekë;
- ii) për mjete, që transportojnë lëndë të rrezikshme 200 000 000 lekë;
- iii) për mjete të tjera, përfshirë mjetet e paidentifikuara 55 000 000 lekë;

b) për dëme, të lidhura me dëmtimin apo shkatërrimin e pronës, nga një ngjarje:

- i) për autobusë dhe kamionë, përfshirë rimorkiot 20 000 000 lekë;
- ii) për mjete, që transportojnë lëndë të rrezikshme 20 000 000 lekë;
- iii) për mjete të tjera, përfshirë mjetet e paidentifikuara 15 000 000 lekë.

c) Brenda kufijve minimalë të përgjegjësisë, të përcaktuar në shkronjat a) dhe b) më sipër, dëmet jopasurore ndaj personit të shkaktuara nga një ngjarje e vetme, përbëhen nga format e mëposhtme dhe nuk mund të tejkalojnë limitet, si më poshtë:

- i) vlera e dëmit biologjik për çdo person të dëmtuar do të jetë jo më shumë se 110 000 lekë për çdo 10% të shkallës së paaftësisë së përhershme, të pjesshme ose të plotë;
- ii) vlera e dëmit moral, për çdo person të dëmtuar me pasojë paaftësi të përhershme për punë, është nga 3/4 deri në 3/2 e dëmit biologjik sipas pikës i) të shkronjës c) të pikës 1 të këtij seksioni;
- iii) vlera e dëmit ekzistencial, për çdo person të dëmtuar me pasojë paaftësi të përhershme për punë është nga 3/4 deri në 3/2 e dëmit biologjik sipas pikës i) të shkronjës c) të pikës 1 të këtij seksioni;

2. Kufiri minimal i përgjegjësisë për çdo person të dëmtuar në një ngjarje sigurimi, sipas shkronjës “a” dhe shkronjës “c”, të pikës 1, është 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë.

3. Për kontratat e lidhura nga data 1 janar 2022 deri në datën 31 dhjetor 2026, kufiri minimal i përgjegjësisë i përcaktuar në këtë pikë do të rritet:

- a) 4 000 000 (katër milionë) lekë çdo vit për mjetet e përcaktuara në nëndarjen “iii” të shkronjës “a”, pika 1;
- b) 2 000 000 (dy milionë) lekë çdo vit për çdo person sipas pikës 2.

4. Për kontratat e lidhura nga data 1 janar 2027 dhe në vijim, kufiri minimal i përgjegjësisë është i njëjtë me kufirin minimal të përgjegjësisë së kontratave të lidhura në vitin 2026.

1.6 Primi i sigurimit për TPL e brendshme

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet ndarja për kategori: motoçikleta, autovetura, furgona dhe mikrobusë, autobusë, kamionçina, kamionë, rimorkio, mjete bujqësore, dhe zjarrfikëse.

Kategoria me më shumë risqe të ekspozuara, është kategoria B1, ajo e autoveturave. Për kategorinë e autoveturave të produktit të sigurimit të detyrueshëm motorik, MTPL e brendshme, prej datës 1 janar 2025, ka hyrë në fuqi Rregullorja nr. 156, datë 19.09.2024 “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përllogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”. Kjo rregullore, ndër të tjera, ka për qëllim hartimin e rregullave për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përllogaritjen e primit të sigurimit në sektorin e transportit në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe përcaktimin e metodologjisë që do të përdoret në aplikimin e faktorëve të riskut.

1.7 Tabela e shërbimeve me çmimet e unifikuara

“SIGURIM I DETYRUESHËM I MJETEVE MOTORIKE TPL”				Nr. Mjeteve	Primi mesatar i sigurimit/mjet (me taksë)
Kat.	Klasa	Tipi	Kapaciteti Motorik (cm3) ose pesha bartëse (T) ose numri i vendeve		
A1		Motoçikleta	Kapaciteti Motorik		
	A1/1		deri në 150cm3		6,719
	A1/2		mbi 150cm3		10,306
B2		Furgon/ Mikrobusë	Nr. Vendeve		
	B2/1		5 deri 8 vende		29,257
	B2/2		mbi 8 deri 15 vende		34,825
C1		Autobusë	Nr. Vendeve		
	C1		mbi 15 vende		58,659
D1		Kamionçina	Pesha mbajtëse (Ton)		
	D1/1		deri në 3.5 ton		28,179
D2		Kamionë	Pesha mbajtëse (Ton)		
	D2/1		mbi 3.5 ton		43,146
E		Rimorkio			13,296
F		Mjete bujqësore			10,906
G		Zjarrfikëse			24,659

* Në përlllogaritjen e primit të sigurimit, për kategorinë e autoveturave B1, shoqëria e sigurimit zbaton këta faktorë kryesorë risku:

- a. Historiku i dëmeve, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit;
- b. Fuqia motorike;
- c. Mosha e të sigurvearit;
- d. Eksperiencia në drejtimin e mjetit motorik;
- e. Përdorimi i mjetit: subjekt, individ;
- f. Qarku i regjistrimit të mjetit;
- g. Vjetërsia e mjetit.

Shoqëria e sigurimit mund të zbatojë edhe faktorë të tjerë risku, përveç atyre të parashikuar më sipër.

Më poshtë paraqiten faktorët e riskut të ndarë sipas klasave:

- a) Historiku i dëmeve për të sigurvearin, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit. Ky faktor ndahet në tri klasa, si vijon:

Klasa

- I. Asnjë dëm të raportuar gjatë vitit
- II. Një dëm të raportuar gjatë vitit
- III. Dy ose më shumë dëme të raportuara gjatë tre viteve të fundit

- b) Fuqia motorike ndahet në shtatë klasa, si më poshtë:

Klasa

- I. deri në 1300 cm³
- II. nga 1301 deri në 1600 cm³
- III. nga 1601 deri në 1800 cm³
- IV. nga 1801 cm³ deri në 2000 cm³
- V. nga 2001 cm³ deri në 2500 cm³
- VI. nga 2501 cm³ deri në 3000 cm³
- VII. mbi 3000 cm³

- c) Mosha e të sigurvearit ndahet në dy klasa, si vijon:

Klasa

- I. 18 – 21 vjeç
- II. Të tjerë

- d) Eksperiencia në drejtim të mjetit motorik. Për të sigurvearit e ndryshëm nga 18 deri në 21 vjeç, ndahet në dy klasa si vijon:

Klasa

- I. Deri në dy vite

II. Mbi dy vite

e) Përdorimi i mjetit: subjekt, individ, ndahet në dy klasa si vijon:

Klasa

- I. Individ
- II. Subjekt

f) Qarku i regjistrimit të mjetit, i cili ndahet në dy klasa si më poshtë:

Klasa

- I. Berat, Dibër, Kukës
- II. Të tjera

g) Vjetërsia e mjetit: indeksi ndahet në katër klasa si më poshtë, vijon:

Klasa

- I. deri në 5 vjet
- II. nga 6 deri në 10 vjet
- III. nga 11 deri në 15 vjet
- IV. mbi 15 vjet

Në rastin e mjeteve motorike në pronësi të subjekteve do të zbatohen faktorët: fuqia motorike, përdorimi i mjetit, qarku i regjistrimit të mjetit, si dhe vjetërsia e mjetit, pra, faktorët e listuar në pikat b), e), f) dhe g). Subjektet, për primin e sigurimit të kategorisë së autoveturave, do të marrin oferta individuale rast pas rasti, ku çmimi do të përcaktohet në bazë të faktorëve specifikë të riskut që ndikojnë në nivelin e rrezikut. Kjo qasje synon që të ofrojë një sigurim më të drejtë dhe të personalizuar për çdo subjekt, duke ekspozuar realisht ekspozimin ndaj riskut dhe duke nxitur sigurinë në përdorimin e automjeteve.

Gjithashtu, përveç faktorëve të riskut të parashikuar në Rregulloren nr. 156, datë 19.09.2024 “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlllogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, shoqëria e sigurimit mund të zbatojë edhe faktorë të tjerë risku, përveç atyre të parashikuar më sipër.

1.2 “Sigurim kasko i mjeteve motorike”

1.2.1 Objekti

Kontrata e sigurimit Kasko është një kontratë vullnetare sipas së cilës, siguruesi ofron mbulim për mjetin motorik, i klasifikuar si i tillë në aktet ligjore e nënligjore, lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të tij, si rezultat i rreziqeve të zgjedhura nga klienti, në përputhje me përcaktimet e bëra në kontratën e sigurimit me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit. Në ndryshim nga sigurimi i detyrueshëm, kjo kontratë ofron mbulim edhe në rastin kur i siguruari është fajtor në një aksident.

1.2.2 Mbulimet

Zakonisht mbulimet/rreziqet e siguruara janë si më poshtë:

- Dëmtime aksidentale: përplasje e automjetit me një objekt fiks ose të lëvizshëm, përmbysja e mjetit motorik;
- Thyerja e xhamave të përparmë, të pasmë, anësorë, të tavaneve të hapur, shkaktuar këto nga goditja e një objekti të lëvizshëm;
- Zjarri, rrufeja, eksplozioni: dëmet e shkaktuara nga zjarri, eksplozioni dhe rrufeja;
- Katastrofa natyrore apo dëmet e shkaktuara nga: stuhia, breshëri, dëbora, tufani, përmytja, vërshimi dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorik nga rënia e objekteve të ndryshme që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore;
- Vjedhja: dëmet që vijnë si pasojë e veprimeve të përvetësimit në mënyrë të fshehtë të mjetit motorik të siguruar, nga një ose disa persona, i të gjithë automjetit (vjedhje totale) ose i disa pjesëve të tij (vjedhje e pjesshme);
- Dëmtime në parkim (pa autor): dëmet që pëson mjeti motorik gjatë qëndrimit i parkuar diku, për të cilat nuk dihet shkaktari i dëmit;
- Dëmtime nga aktet keqdashëse: dëmet që shkaktohen nga aktet keqdashëse mbi mjetin motorik të siguruar, gjatë qëndrimit ose qarkullimit të tij, duke filluar nga dëmtimet keqdashëse e deri tek dëmtimet dhe akte të tjera përfshirë edhe ato terroriste;
- Transport me karroatrec;
- Sigurim jashtë Shqipërisë.

Primi i sigurimit është në funksion të mbulimeve të zgjedhura, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorik, shumës së siguruar, historikut të dëmeve si dhe natyrisht të kushteve të tregut.

Siguruesi do të dëmshpërblejë të siguruanin deri në shumën e siguruar, për të cilën është rënë dakord në kontratën e sigurimit midis siguruesit dhe të sigurvearit. Ajo mund të jetë sa:

- vlera e blerjes së mjetit motorik, nëse ky i fundit merret në sigurim në momentin e vënies në qarkullim për herë të parë, ose sa
- vlera e tregut.

1.2.3 Njoftimi dhe trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim

Për çdo rast dëmi, i siguruari është i detyruar t'i paraqesë siguruesit kërkesën dhe dokumentacionin për dëmshpërblim, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e sigurimit. Për çdo rast dëmi, siguresi, bazuar në kushtet e kontratës, zbret nga shpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme apo franshizën.

1.2.4 Lista e shërbimeve me çmimet e unifikuara

SIGURIMI KASKO I MJETEVE MOTORIKE			Primi mesatar si % mbi shumën e siguruar/mjet (me taksë)
Nr.	Periudha e Sigurimit	Rreziqet e siguruar	
1	1 vit	Rreziqet bazë:	3.77%
		Dëmtimet aksidentale	1.78%
		Thyerja e xhamave	0.33%
		Zjarr, rrufe, eksplozion	0.32%
		Katastrofa natyrore	0.33%
		Dëmtim në parkim nga një mjet i paidentifikuar	1.00%
2	1 vit	Rreziqet shtesë :	4.0%
		Vjedhje totale	1.00%
		Vjedhje e pjesshme	1.00%
		Dëmtime nga aktet keqdashëse	1.00%
		Transport me karroatrec	0.17%
		Sigurim jashtë Shqipërisë	0.83%
		KASKO E PLOTË Primi (me taksë) për Totalin e rreziqeve (bazë + shtesë) si % e Shumës së siguruar	7.77%

2. SIGURIM I MJETEVE LUNDRUESE

2.1 Objekti

Objekt i kësaj kontrate është:

- sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit ujqor, në përputhje me parashikimet ligjore e rregullatore dhe brenda kufijve të rënë dakord, lidhur me dëmet jopasurore dhe pasurore të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit ujqor lundrues të siguruar, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 32, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë, si dhe mbulimi i rreziqeve me sigurimin Kasko.

2.2 Fusha e veprimt

Sigurimi i detyrueshëm i mjeteve lundruese, përfshin sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit lundrues për dëmet jopasurore dhe pasurore të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

Siguruesi mbulon përgjegjësinë ndaj palëve të treta, në kufijtë që përfshihen në koordinatat gjeografike të përcaktuara në certifikatat e mjetit lundrues, lëshuar nga Administrata Detare e Republikës së Shqipërisë, në detin Adriatik, detin Jon, liqenet dhe ujërat e brendshme të RSH-së. Në palët e treta nuk përfshihen personat në bordin e mjetit të vogël lundrues, shkaktarë të dëmit dhe as personat në mjetin tjetër lundrues ose në bordin e ndonjë mjeti tjetër lundrues.

2.3 Sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit të mjetit lundrues për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

Pronari i mjetit lundrues, me fuqi motorike më të madhe se 15 KW, që sipas rregullave të regjistrimit të mjeteve lundruese duhet të regjistrohet në regjistrin e mjeteve lundruese gjatë lundrimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi të përgjegjësisë për dëmet ndaj pronës dhe ndaj personit, të shkaktuara ndaj palëve të treta.

Polica e sigurimit hyn në fuqi në orën 24:00 të ditës së përcaktuar në policën e sigurimit si datë e fillimit të mbulimit, me kushtin që të jetë paguar primi i sigurimit, kur nuk është përcaktuar ndryshe në kontratën e sigurimit, si dhe të jetë nënshkruar kontrata midis siguruesit dhe të siguruarit.

2.4 Kufiri minimal i përgjegjësisë

Detyrimi i shoqërisë së sigurimit për kompensimin e dëmeve, është i barabartë me shumën e siguruar, të vlefshme në ditën e ngjarjes së sigurimit, përveç rasteve kur në kontratën e sigurimit është përcaktuar një shumë më e lartë. Shuma minimale e siguruar në kontratën e sigurimit, për çdo ngjarje të vetme është 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

2.5 Trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim

Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i siguruari duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e arsyeshme (mundësisht brenda 24 orësh), Kapitenerinë e Portit dhe siguruesin lidhur me ngjarjen dhe kërkesa për dëmshpërblim nga i siguruari duhet të marrë të gjitha hapat e arsyeshme për të ndaluar apo për të minimizuar çdo humbje që do të ishte e dëmshpërbllyeshme sipas këtij siguracioni si dhe të minimizojë përgjegjësinë ndaj palëve të treta. I siguruari duhet të bashkëpunojë plotësisht me siguruesin për të siguruar informacionin dhe dëshmitë e duhura dhe duhet të lejojë siguruesin që të procedojë në emër të tij, por me shpenzimet e siguruesit për të fituar dëmshpërblim nga ndonjë palë e tretë në lidhje me mbulimet sipas këtij siguracioni.

2.6 Humbja dhe dëmtimi i mjetit lundrues (KASKO)

Sigurimi kasko i mjetit lundrues, mbulon deri në vlerën e deklaruar në kontratën e sigurimit të gjitha rreziqet e humbjeve apo dëmtimeve fizike që shkaktohen nga aksidente që përfshijnë edhe vjedhjen, sipas përcaktimeve dhe mbulimeve në kontratën e sigurimit. Përgjegjësia e siguruesit, nuk duhet të kalojë shumën e sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit, me kusht që kësaj shume t'i hiqet pjesa e zbritshme.

2.7 Tabela e shërbimeve dhe çmimet e unifikuara

SIGURIM I MJETEVE LUNDRUESE

Kat.	Tipi i mjetit lundrues	Fuqia Motorrike (HP)	Viti prodhimit	Gjatësia	Shuma e Siguruar për Trupin e Anijes (Vlera e anijes)	Limiti i Përgjegjësisë ndaj paleve të treta (Shuma e Siguruar)	A Primi mesatar për mbulimin Kasko (me taksë)	B Primi mesatar për mbulimin TPL (Përgjegjësisë ndaj palëve të treta) (me taksë)		Primi total i sigurimit (A+B) në Lekë pa TVSH
								6 muaj	12 muaj	
A	Motor Uji (YET)	15 deri në 50 KW				50.000.000	4.33%	5,667	7,960	
B	Motor Uji (YET)	50 deri në 150 KW				50.000.000	4.33%	7,333	11,362	
C	Gomone + Skaf Plastik (Rezinë)			deri në 6 metër		50.000.000	4.17%	10,000	14,005	
D	Gomone + Skaf Plastik (Rezinë)	mbi 100 KW		nga 6-15 metër		50.000.000	4.17%	13,000	19,865	
E	Yaht (dru / plastik)			deri në 24 metra		50.000.000	4.17%	31,333	40,633	
F	Varkë me vela					50.000.000	4.00%	9,667	12,333	

3. SIGURIM I MJETEVE AJRORE

3.1 Objekti

Objekt i kësaj kontrate është sigurimi i përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të avionit për dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 32, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, si edhe mbulimin e rreziqeve nga sigurimi Kasko.

3.2 Fusha e veprimit

Sigurimi i detyrueshëm i mjeteve ajrore përfshin sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të avionit për dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni.

Kjo kontratë sigurimi mbulon përgjegjësinë e të siguarit ndaj palëve të treta për dëme të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në territoret e shteteve të tjera, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje.

3.3 Sigurimi i përgjegjësisë së pronarëve të avionëve për dëmin e shkaktuar palëve të treta.

Pronari i avionit të regjistruar në regjistrin shqiptar të avionëve civilë duhet të lidhë një kontratë sigurimi të përgjegjësisë për çdo dëm dhe/ose humbje shkaktuar palëve të treta përgjatë përdorimit të avionit.

Kontrata e sigurimit mbulon:

- a) dëme shkaktuar palëve të treta me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore dhe dëmtim ose shkatërrim të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;
- b) dëme shkaktuar pasagjerëve me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore gjatë fluturimit të avionit;
- c) dëmtime ose humbje të sendeve personale të pasagjerëve, që janë të vendosura në kabinën e avionit;
- ç) dëmtime ose humbje të mallrave në transport (cargo) dhe të bagazheve, që kanë kaluar procesin e regjistrimit.

Palë e tretë quhet çdo person i ndryshëm nga pasagjeri apo anëtar i ekuipazhit të fluturimit ose i kabinës së avionit gjatë fluturimit të avionit.

Pasagjer quhet çdo person që transportohet nga një avion, me dijeninë e transportuesit ajror ose të drejtuesit të avionit. Termi pasagjer nuk përfshin personelin në detyrë të ekuipazhit të fluturimit dhe të ekuipazhit të kabinës, të cilët janë në detyrë gjatë fluturimit.

3.4 Përgjegjësia ligjore për palët e treta (përveç pasagjerëve)

Siguruesi do të dëmshperblejë të sigruarin për të gjitha shumat për të cilat, i siguruari do të bëhet ligjërisht përgjegjës për të paguar, si dhe do të paguajë kompensim për dëmet (duke përfshirë kostot që i ngarkohen të sigruarit) në lidhje me dëmtimet trupore aksidentale (fatale ose jo) si dhe dëmtimet aksidentale të pasurisë të shkaktuara nga avioni ose nga çdo person apo objekt që bie nga avioni. Përgjegjësia e sigruarit, sipas këtij seksioni, nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në kontratën e sigurimit, me kusht që kësaj shume do t'i hiqet pjesa e zbritshme.

3.5 Përgjegjësia ligjore për pasagjerët

Siguruesi do të dëmshperblejë të sigruarin në lidhje me të gjitha shumat për të cilat, i siguruari do të bëhet ligjërisht përgjegjës për të paguar, si dhe do të paguajë si kompensim për ato dëme (duke përfshirë shpenzimet e gjyqit në ngarkim të të sigruarit) që lidhen me:

- plagosjet trupore aksidentale (fatale apo jo) të pasagjerëve gjatë kohës që janë duke hyrë, janë në bord, ose janë duke dalë nga avioni, dhe
- humbjen ose dëmtimin e bagazheve dhe sendeve personale të pasagjerëve që vjen si pasojë e një aksidenti të avionit.

Përgjegjësia e sigruarit, sipas këtij seksioni, nuk do të kalojë shumën e përcaktuar në kontratën e sigurimit, me kusht që kësaj shume do t'i hiqet pjesa e zbritshme.

3.6 Kufiri minimal i përgjegjësive

Përgjegjësia e sigruarit, që rrjedh nga kontrata e sigurimit, korrespondon me shumën e sigruar në fuqi në datën kur ka ndodhur humbja, përveç rasteve kur sipas kontratës, shuma e sigurimit është më e lartë.

Përgjegjësia minimale për një ngjarje të përcaktuar në kontratën e sigurimit është sipas përcaktimeve në nenin 53 të Ligjit 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

3.7 Humbja dhe dëmtimi i avionit (KASKO)

Kjo kontratë sigurimi mbulon humbjet ose dëmet e shkaktuara, jashtë vullnetit të të sigurvearit, nga një aksident i ndodhur gjatë periudhës së sigurimit, në masën dhe mënyrën e parashikuar në kontratën e sigurimit. Ngjarjet e mbuluara janë sipas përcaktimeve në kontratën e sigurimit, siç janë:

- Aksidentet, ngjarje të veçanta të shkaktuara nga veprimi i forcave të jashtme;
- Aksidentet në operacionet e stacionimit;
- Thyerja e xhamave;
- Zjarri, rrufeja, eksplozioni;
- Dëmet e shkaktuara nga katastrofat natyrore: breshëri, dëbora, furtuna, rrëshqitja e dheut, rënia e gurëve;
- Vjedhja, dëmet ose prishjet e shkaktuara nga vjedhja me thyerje e pjesëve të avionit.

Siguruesi, sipas zgjedhjes së tij, do të paguajë për zëvendësimin apo riparimin e humbjes aksidentale ose dëmtimit të avionit që rrjedhin nga rreziku i mbuluar, duke përfshirë zhdukjen nëse avioni nuk gjendet për 60 ditë pas fillimit të fluturimit, por kjo pagesë nuk do të kalojë shumën e sigurvearit, të përcaktuar në kontratën e sigurimit, me kusht që kësaj shume do t'i hiqet pjesa e zbritshme.

Nëse avioni është sigurvearit për rreziqet në fluturim, siguruesi do të paguajë edhe shpenzimet emergjente të nevojshme dhe të arsyeshme që kryen i sigurvearit për eliminimin e menjëhershëm të pasojave të dëmtimit ose uljes së detyruar të avionit, deri në 10% të shumës së specifikuar në formularin e sigurimit.

3.8 Tabela e shërbimeve me çmimet e unifikuara

SIGURIM I MJETEVE AJRORE												
Të dhënat e mjetit ajror							1. Mbulimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta (TPL)		2. Mbulimi KASKO		3. Mbulimi i pasagjerëve	
Nr	Prodhimi, Tipi i mjetit, Nr. serisë	Nr.Anëtar	Masa max e ngritjes në Kg	Nr. max. I pasagjerëve i deklaruar në çdo kohë	Viti i prodhimit	Motorri, numri dhe Tipi	Limiti i përgjegj. ndaj palëve të treta (Shuma e siguruar për mbulim TPL) (lekë)	Primi mesatar i përgjegjësisë të sigurimit ndaj palëve të treta (% e limitit të mbulimit) (me taksë)	Vlera e mjetit në LEK (shuma e siguruar për mbulim Kasko)	Primi mesatar i sigurimit Kasko (% mbi shumën e siguruar) (me taksë)	Limiti i përgj. Ndaj pasagjerëve/ Shuma e siguruar (lekë)	Primi mesatar i sigurimit të përgjegjësisë ndaj pasagjerëve (% e limitit të mbulimit) (me taksë)
1								0.47%		4.67%		0.35%
	Primi në lekë							1		2		3
	Primi total i sigurimit (1+2+3)											

4. SIGURIM I GODINAVE PUBLIKE

4.1 Kushtet e përgjithshme të sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë

Kontrata e sigurimit të pronës është një kontratë vullnetare, sipas së cilës siguresi ofron mbulim për humbjen ose dëmtimin e pasurisë së siguruar, lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të saj, si rezultat i rreziqeve të zgjedhura nga klienti, në përputhje me përcaktimet e bëra në kontratën e sigurimit, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit.

4.2 Objekti i sigurimit

I siguruari mund të sigurojë pranë siguresit pasuri që i ka në pronësi të tij ose në çdo formë tjetër të pronësisë, me kusht që të ketë një kontratë sipas kërkesave ligjore me pronarin e pasurisë apo sendit. Siguresi ofron sigurim për objektet e mëposhtme:

- a. pasurinë e paluajtshme, ndërtesat dhe pjesë të tjera të njësisë së siguruar, ku njësi e siguruar do të konsiderohen ndërtesat, dhomat e ndërtesave ose vendet e përcaktuara si të tilla në kontratë;
- b. pasurinë e luajtshme, ku si të tilla konsiderohen të gjitha pajisjet dhe mallrat të cilat ndodhen në një ndërtesë dhe nuk janë të lidhura pazgjidhshmërisht me të. Nuk përbëjnë objekt sigurimi të kësaj kontrate sendet vetjake që u përkasin dhe përdoren nga punonjësit, përveç rasteve kur janë përcaktuar shprehimisht në kontratën e sigurimit.

4.3 Rreziqet e sigurimit

Siguresi dëmshpërblen të siguarin për humbjen ose dëmtimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e:

- a. zjarrit;
- b. rrufesë;
- c. eksplozionit;
- d. përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij;
- e. përpjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me çdo njerën prej ngjarjeve të mësipërme në përputhje me kufirin e përcaktuar në kontratën e sigurimit.

Mbulimet e mësipërme janë pjesë e mbulimeve bazë të kontratës së sigurimit të pronës. Ndërsa mbulime të tjera shtesë janë:

- f. Tërmeti;
- g. Stuhia;
- h. Breshëri;
- i. Përmbytja;
- j. Rrëshqitja e tokës;
- k. Rrjedhja e tubacioneve;
- l. Aktet keqdashëse;
- m. Sigurimi i xhamave.

4.4 Shuma e siguruar

Shuma e siguruar, si rregull, do të jetë e barabartë me vlerën e sigurimit. Baza mbi të cilën do të përcaktohet shuma e siguruar, do të vendoset në policën e sigurimit.

- a. Për ndërtesat, shuma e sigurimit do të jetë:
 - 1. Vlera e zëvendësimit të saj, e cila është vlera lokale e ndërtimit, duke përfshirë shpenzimet për arkitektin apo shpenzime të tjera për projektimin;
 - 2. Vlera aktuale, nëse është më e vogël se ajo e zëvendësimit, ku vlera aktuale është vlera e zëvendësimit të ndërtesës minus një zbritje në përputhje me gjendjen aktuale të saj, në veçanti me shkallën e amortizimit;
 - 3. Vlera e tregut, nëse është më e vogël se vlera aktuale, ku vlera e tregut do të jetë e barabartë me çmimin e mundshëm të shitjes së ndërtesës ose vlerën e materialit që mund të përfitojë i siguruari nga prishja e saj.
- b. Për makineritë dhe pajisjet, shuma e sigurimit do të jetë:
 - 1. Vlera e zëvendësimit, e cila do të jetë vlera për t'u paguar për blerjen ose prodhimin e objekteve të të njëjtit tip dhe cilësi në një gjendje si të reja, cilado qoftë shuma më e ulët;
 - 2. Vlera e tregut, kur në raste të veçanta një makineri, grup makinerish ose pajisjesh nuk mund të përdoren më ose nuk janë të përdorshme për qëllimin e të siguarit. Vlera e tregut do të jetë e barabartë me çmimin e mundshëm të shitjes së objektit ose vlerën e materialit që mund të përfitojë i siguruari nga shitja e pjesëve të tij.
- c. Për mallrat që prodhohen, tregtohen, lëndë të para dhe/ose produkte natyrore, shuma e sigurimit do të jetë e barabartë me vlerën maksimale të tyre, e cila përfaqëson vlerën maksimale të mundshme të mallrave të depozituara, deklaruar me shkrim nga i siguruari. Në raste të veçanta, shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën

mesatare të tyre, e cila përfaqëson vlerën mesatare që i siguruari parashikon të ketë gjatë vitit, deklaruar me shkrim nga i siguruari.

4.5 Polica dhe periudha e sigurimit

Kontrata e sigurimit lidhet në bazë të kërkesës me shkrim të të siguarit, të pyetësorit dhe kërkesës për sigurim, si dhe deklarimeve të bëra nga i siguruari. Siguruesi lëshon policën e sigurimit, të nënshkruar prej tij, dokument i cili vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit.

Periudha e sigurimit, si rregull, është jo më pak se një vit, përveç rasteve kur në policën e sigurimit përcaktohet ndryshe.

4.6 Primi i sigurimit

Primi i sigurimit për këtë kontratë është në funksion të veçorive të llojit të pasurisë së siguar, shumës së siguar, mbulimeve të zgjedhura, historikut të dëmeve si dhe kushteve të tregut. Siguruesi do të dëmshpërblejë të siguarin, deri në shumën e siguar për të cilën është rënë dakord në kontratën e sigurimit, midis siguruesit dhe të siguarit. I siguruari detyrohet t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit ose kështet e tij sipas shumave dhe afateve të përcaktuara në kontratë. Primi i sigurimit paguhet në monedhën e përcaktuar në policën e sigurimit.

4.7 Ngjarja e sigurimit dhe kërkesa për dëmshpërblim

Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i siguruari, brenda afateve të përcaktuara në kontratën e sigurimit, duhet të njoftojë me shkrim siguruesin, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, si dhe të njoftojë organet e rendit dhe njësitë zjarrfikëse. Siguruesi ka detyrimin të dëmshpërblejë të siguarin deri në masën e shumës së siguar, pasi të jetë zbritur pjesa e zbritshme apo franshiza, sipas përcaktimeve në policën e sigurimit. Siguruesi, brenda 30 ditëve nga marrja e dokumentacionit të plotë të lidhur me ngjarjen e siguar, duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit.

4.9 Lista e shërbimeve me çmimet e unifikuara

Sigurim i godinave publike			
Sigurimi i pasurisë nga rreziqet bazë dhe rreziqet shtesë			Primi mesatar si % mbi shumën e siguruar (me taksë)
Nr	Periudha e sigurimit	Rreziqet e siguruara	
1	1 Vit	Rreziqet Bazë:	0.183%
		Zjarr	
		Rrufe	
		Eksplizion	
		Përplasje ose rënie e avionit ose pjesëve të tij	
		Përprjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me çdo njërën prej ngjarjeve të mësipërme.	
2	1 Vit	Rreziqet Shtesë:	
		Tërmeti	0.080%
		Stuhia	0.050%
		Breshëri	0.050%
		Përmytja	0.077%
		Rrëshqitja e tokës	0.050%
		Rrjedhja e tubacioneve	0.050%
		Aktet keqdashëse	0.173%
		Sigurimi i xhamave	0.077%
Primi mesatar total (me taksë) si % e shumës së siguruar			0.790%